



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1697/6 prot.

Datë 23.08.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 807/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.08.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74343-07-05-2023, me objekt: “Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës”, me fond limit 59.500.000 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 07.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Alb Garden” SHPK  
Lagja “Skënderbeg”, godinë private 1 katëshe, Superstrada Lezhë-Shkodër, Lezhë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë  
Rruga “5 Maji”, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.07.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74343-07-05-2023, me objekt: “Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës”, me

fond limit 59.500.000 lekë (pa TVSh), parashikuar për t'u zhvilluar në datë 07.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.

II.2. Në datën 14.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ankesa e operatorit ekonomik “Alb Garden” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2023/3270, protokolluar me nr. 1697/2023 prot., datë 14.07.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën me Nr. 1207/10 prot., datë 21.07.2023 protokolluar me tonën me nr.1697/2 prot., datë 24.07.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Alb Garden” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, duke pranuar pretendimin lidhur **me pikën 1** të ankesës (saktësimi i artikujve të cilët nuk figurojnë në shtojcën 6), është pranuar pretendimi lidhur **me pikën 3** të ankesës (pikën 2.3.4 kapaciteti teknik të dokumenteve standarde të tenderit në lidhje me uljen e numrit të punëtorëve nga 49 punonjës në 25 punonjës), është pranuar pretendimi lidhur **me pikën 4** të ankesës (duke e hequr kriterin për punonjës në lartësi).

II.6. Në datën 03.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr.719/2023, datë 03.08.2023, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-74343-07-05-2023, me objekt “Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës” me fond limit 59,500,000.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar me datë 07.08.2023, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Me anë të shkresës nr.949/1 prot., datë 27.07.2023, protokolluar pranë KPP me nr.1697/3 prot., datë 01.08.2023, operatori ekonomik “Alb Garden” SHPK, ka paraqitur argumente shtesë në lidhje me trajtimin e ankesës së tij nga ana e autoritetit kontraktor. Konkretisht operatori ekonomik pretendon si më poshtë:

- “1. AK e ka pranua plotësisht pretendimin nr.1 të sipërcituar;*
- 2. AK e ka pranuar pjesërisht pretendimin nr.2 të sipërcituar, duke ndryshuar kriterin për vjetërsinë në punë të Inxhinierëve nga 5 vite eksperiencë në 3 vite eksperiencë;*
- 3. AK e ka pranuar plotësisht pretendimin nr.3 të sipërcituar, duke e ulur numrin e punëtorëve nga 49 punonjës në 25 punonjës;*
- 4. AK e ka pranuar plotësisht pretendimin nr.4 të sipërcituar, duke e hequr kriterin për punonjës në lartësi;*
- 5. AK nuk e ka pranuar pretendimin nr.5 të sipërcituar, për heqjen e kriterit të paraqitjes së mostrave;*
- 6. AK e ka pranuar pjesërisht pretendimin nr.6 të sipërcituar, duke hequr disa mjete e makineri si dhe duke ulur numrin e mjeteve e makinerive që OE duhet të disponojnë.*
- 7. AK deklaron se e ka pranuar pretendimin nr.7 të sipërcituar, duke na vënë në dispozicion disa foto me vendndodhjet se ku do të mbillen drurët dekorativë.*

*Lidhur me pretendimet 2, 5 dhe 7 të cilat AK ose i ka pranuar pjesërisht (pretendimet 2 dhe 7) ose nuk e ka pranuar (pretendimi nr.5), pasi jemi njohur me përgjigjen e AK me anë të kësaj shkrese paraqesim dhe sjellim në vëmendje të KPP disa argumente shtesë. [...]*”.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alb Garden” ShPK, se: “[...] Në shtojcën 7, pika 2 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nën-pika 2.3 Kapaciteti teknik, AK ka kërkuar kriteret: “2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor që të kenë stafin inxhinierik si më poshtë te cilin ta kete te punesuar te pakten në 3 muajt e fundit dhe te kenë te pakten 5 vite eksperiencë pune, si dhe te përfshirë në licencen e shoqerise si më poshtë:

- |    |                    |         |
|----|--------------------|---------|
| a. | Inxhinier Topograf | 1 (një) |
| b. | Inxhinier Agronom  | 2 (dy)  |

- c. *Inxhinier Mjedisi* 1 (një)  
d. *Inxhinier Pyjesh* 1 (nje)

*Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqes për fuqinë punëtore dokumentacionin (original ose kopje e noterizuar) të sipërcituar.*

*Gjithashtu për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:*

- *CV*
- *Kontratë pune të vlefshme*
- *Diplomë*
- *Licencë (nëse është e zbatueshme / nëse Inxhinieri është i pajisur me licencën përkatëse, referuar nenit 40/5/(b) të VKM 285, datë 19.05.2021)*
- *Libreze pune*

*Lidhur me këtë kërkesë të AK, konstatojmë se përcaktimi i kërkuar nga AK që stafi Inxhinierik duhet të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune është një kërkesë e pambështetur ligjërisht dhe totalisht diskriminuese.[...]*

*Për pasojë ky kriter duhet të modifikohet, duke hequr kërkesën për 5 vite eksperiencë pune.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 7, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor që të kenë stafin inxhinierik si më poshtë te cilin ta kete te punesuar te pakten në 3 muajt e fundit dhe te kenë te pakten 5 vite eksperiencë pune, si dhe te përfshirë në licencen e shoqerise si më poshtë:*

- a. *Inxhinier Topograf* 1 (një)  
b. *Inxhinier Agronom* 2 (dy)  
c. *Inxhinier Mjedisi* 1 (një)  
d. *Inxhinier Pyjesh* 1 (nje)

*Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqes për fuqinë punëtore dokumentacionin (original ose kopje e noterizuar) të sipërcituar.*

*Gjithashtu për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:*

- *CV*
- *Kontratë pune të vlefshme*
- *Diplomë*
- *Licencë (nëse është e zbatueshme / nëse Inxhinieri është i pajisur me licencën përkatëse, referuar nenit 40/5/(b) të VKM 285, datë 19.05.2021)*
- *Libreze pune*

III.1.2. Autoriteti kontraktor pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Alb Garden” ShPK, ka pranuar pjesërisht pretendimin e këtij të fundit, si më poshtë:

“AK ka modifikuar pikën 2.3.3 tek “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, duke kryer ndryshimet përkatëse si më poshtë:

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor që të kenë stafin inxhinierik si më poshtë të cilin ta kete të punësuar të pakten në 3 muajt e fundit dhe të kenë të pakten 3 vite eksperiencë pune, si dhe të përfshirë në licencën e shoqërisë si më poshtë:

a.	Inxhinier Topograf	1 (një)
b.	Inxhinier Agronom	2 (dy)
c.	Inxhinier Mjedisi	1 (një)
d.	Inxhinier Pyjesh	1 (një)

Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqes për fuqinë punëtore dokumentacionin (original ose kopje e noterizuar) të sipërcituar.

Gjithashtu për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- CV
- Kontratë pune të vlefshme
- Diplomë
- Liçence (nëse është e zbatueshme / nëse Inxhinieri është i pajisur me liçencën përkatëse, referuar nenit 40/5/(b) të VKM 285, datë 19.05.2021)
- Libreze pune”

III.1.3. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

[...]

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.1.4. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “ 3. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

Në nenin 40 pika 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*5.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me



dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së.

Në rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit si dhe volumit të furnizimeve dhe mbjelljes, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor lidhur me eksperiencën e stafit inxhinierik është e ekzagjeruar dhe jo në proporcion me furnizimet dhe vendosjen që do të kryhen nga operatori ekonomik potencialisht fitues në këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim referuar bazës ligjore sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterit duke rishikuar edhe njëherë eksperiencën në punë, në proporcion me objektin e prokurimit në respekt të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Alb Garden” ShPK, se: “[...] së pari referuar kriterit të kërkuar nga AK rezulton se ai nuk është vendosur në përputhje me përcaktimin e mësipërm ligjor, pasi ligjvënësi në nenin 40 pika 6 të VKM 285, ka përcaktuar në mënyrë të qartë se kërkesa e sipërcituar janë alternative dhe jo kumulative, pra AK mund të kërkojë mostrat; dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike të mallit objekt kontrate; dhe/ose dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, ndërkohë që në rastin konkret AK në mënyrë abuzive ka kërkuar edhe mostrat edhe specifikimet teknike, dhe kërkesa të tjera teknike që lidhen me mallin objekt kontrate.

Së dyti kriteri për paraqitjen e mostrave është në kundërshtim me parashikimet ligjore nenit 77 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 VKM 285, pasi kjo kërkesë bie në kundërshtim me objektin dhe natyrën e kësaj kontrate. Sjellim në vëmendjen tuaj se objekt i kësaj kontrate është furnizimi drurëve dhe shkurreve dekorative dhe AK është një autoritet me përvojë në prokurimin e drurëve dhe shkurreve dekorative e në këtë kuadër paraqitja e katalogëve, fotografive apo skedave teknike të bimëve dekorative e përmbush më së miri qëllimin e AK, duke krijuar një panoramë të qartë për mallin që disponon secili konkurrent.

Së treti, kërkesa e AK për paraqitjen e mostrave për disa artikuj që prokurohen bie në kundërshtim të hapur me kërkesat e nenit 77 të Ligjit 162/2020 si dhe shkel në mënyrë flagrante qëllimet dhe parimet e përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të LPP. Më konkretisht sqarojmë se shumë prej bimëve dekorative objekt kontrate rriten/prodhohen jashtë Shqipërisë. Procedura e

prokurimit është publikuar në datë 06.07.2023 dhe është parashikuar për tu zhvilluar në datë 07.08.2023. Është e pamundur të sigurohen dhe paraqiten mostrat e kërkuara nga AK për një afat prej 30 ditësh. Po të marrim në konsideratë identifikimin ekzaktësisht se ku ndodhen bimët dekorative, përgatitjen për eksport të drurëve dhe shkurreve dekorative (mostrave), transportin dhe zhdoganimin e tyre, rezulton se është e pamundur të dorëzohen brenda afatit të kërkuar mostrat pranë AK. Ky fakt vlen si për OE shqiptarë që bashkëpunojnë me OE të huaj ashtu edhe për OE të huaj që duan të konkurrojnë në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, vlera e mallit që AK kërkon të paraqitet si mostër është rreth 12 mijë euro. Kjo përbën një kosto të konsiderueshme në ngarkim të OE që do të konkurrojnë për këtë procedurë prokurimi dhe e cila nuk konsiderohet aspak nga AK. Kjo kërkesë e veçantë kualifikimi haptazi diskriminon OE shqiptarë që bashkëpunojnë me OE të huaj ashtu edhe për OE të huaj që duan të konkurrojnë në këtë procedurë prokurimi, pasi e kanë të pamundur në kohë reale të paraqesin mostra.

Së katërti, sjellim në vëmendjen tuaj se një dru dekorativ që importohet në Shqipëri në mënyrë që të qarkullojë lirisht qoftë edhe të përdoret si mostër, referuar kërkesave të VKM nr.523 datë 13.07.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese” në kreun II, pika 1, gërma “d” përcaktohet se “1.Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi”. Referuar afati kohor dhe procedurave që kërkohet që bimësia e kërkuar për mostër të pajiset me certifikatë përkatëse, rezulton se është e pamundur të arrihet ky afat. Referuar arsyetimit të sipërcituar, kërkojmë që kriteri për paraqitjen e mostrave të hiqet.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7, pika 2.3.10 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.10. Ofertuesi të paraqesë, përpara afatit të fundit për hapjen e ofertave, nga një mostër për artikujt e mëposhtëm:

1. Pishë e butë (*Pinus Pinea*), me perimetër 45\_50 cm në 1.3 m nga toka) / artikulli Nr. 7 në preventiv.

2. Rrap, (*platanus orientalis*), (me perimetër 80\_85 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr.11 në preventiv.

3. Rrap, (*platanus orientalis*), (me perimetër 60\_70 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr. 12 në preventiv.

4. Panjë e kuqe (me perimetër 40\_45 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr. 22 në përeventiv.

5. Tespie (me perimetër 45\_50 cm në 1.3m nga toka) / artikulli Nr.28 në preventiv.

6. Cedër (*Cedrus Deodora*), (me perimetër 55\_60 cm në 1.3 m nga toka) / artikulli Nr. 36 në përeventiv.

Mostrat të paraqiten dhe të dorëzohen në magazinën e DPPGJ (përkatësisht në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, Rruga 5 Maji, Tiranë), së bashku me

*listën e mostrave të protokolluar në DPPGJ përpara afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Një kopje e listës së mostrave të protokollohet dhe të dorezohet në zyrën e protokoll-arkives ne DPPGJ.*

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.4. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.5. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka

parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së.

Në rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Komisioni konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit.

Nga shqyrtimi i kritereve të kualifikimit, KPP vëren, se për disa nga artikujt objekt-prokurimi, konkretisht Pishë e butë (Pinus Pinea; Rrap (platanus orientalis); Rrap (platanus orientalis); Panjë e kuqe; Tespie; Cedër (Cedrus Deodora), kërkohet dorëzimi i mostrave në ambientet e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga operatori ekonomik ankimues, në ankesën e tij, gjykojmë, se referuar objektit të prokurimit si dhe natyrës së produkteve që kërkohet të furnizohet, gjykojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave për artikujt Pishë e butë (Pinus Pinea; Rrap (platanus orientalis); Rrap (platanus orientalis); Panjë e kuqe; Tespie; Cedër (Cedrus Deodora), është një kërkesë e ekzagjeruar dhe që shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit që kërkohet të prokurohet.

Vlen të theksojmë, se qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktet objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret e kualifikimit të hartuara nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë

/përbashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e kriterëve të kualifikimit autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, e cila kufizon pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi.

Akoma më tej, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka në dispozicion edhe momentin procedural të kontrollit të dytë ex post-pas lidhjes së kontratës të përputhshmërisë së produkteve të furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Alb Garden" ShPK, se: "[...]Gjithashtu, pasi jemi njohur me kërkesat tuaja teknike, ju informojmë se ne kemi verifikuar pozicionin e koordinatave gjeografike të kërkuara nga autoriteti kontraktor DPPGJ sipas grafikut FV Pemë, lidhur me çdo rrugë ku kërkohet të mbillen drurët dhe shkurret dekorative. Nga verifikimi konkret që kemi kryer në terren bashkë me inxhinierin Gjeodet, në disa prej koordinatave gjeografike që ju keni përcaktuar në dst, rezulton se ka drurë të mbjellë (të cilët janë identikë në përmasa dhe lloj sipas kërkesave teknike të dst). Ky fakt krijon konfuzion për ne si shoqëri, pasi koordinatat gjeografike në "grafikun e punimeve F.V" AK ka përcaktuar fillimin e rrugës dhe mbarimin e rrugës, nuk kemi koordinatat për secilin dru dekorativ pasi ka mbivendosje dhe konfuzion. Bashkëlidhur do të gjeni sipas planin e riveimit topografik i punuar nga inxh. Gjeodet, fotot dhe perimetrin e drurëve dekorativ. Ku dallohen qartë mbivendosjet e drurëve identik në lloje dhe përmasa sipas kërkesës së AK sipas secifikimeve teknike në dst. Në këto kushte kërkojmë saktësimin e koordinatave duke përcaktuar ekzaktesisht pozicionin për secilin (1/copë) dru dekorativ.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 5, "Formulari i specifikimeve teknike", të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

#### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

##### ***Bimësia dekorative (drurë\_shkurre) dhe kompozimi në gjelbërim.***

*Në sipërfaqet e gjelbëra elementi bazë dhe faktori kryesor që përcakton kompozimin e tyre estetik mbetet gjithmonë bimësia dekorative.*

*Bimësia dekorative mund të lihet me rritje natyrore ose mund ti jepet edhe forma të rregullta sferike dhe gjeometrike, paralelepipedë, konike, etj.*

##### ***Veçoritë e drurëve dekorativë:***

- *drurë me kurorë ovale; Panja, Mështekëna, Ahu, Gështenja, Sofora, Bli, Lisi, etj.*

- drurë me kurorë të rrumbullakët; Gështenja e Kalit, Katabla, Plepi, Shelgu etj.
- drurët me kurorë konike; Likuidambër, Manjolë, Rrapi, Bli, Akacia etj.
- drurë me kurorë si kolonë; Mështekën, Ah, Verri, etj.
- drurë me kurorë sferike; Panja, Frashëri, Akacia etj.
- drurë me kurorë të shtrirë si çadër; Julibrisimi, Plepi i Bardhë, Cedruset, Pishat, etj.
- drurë me kurorë konike; Bredhi, Selvia, Varshi, Gjinko, Kryptomeria, Pisha, Sekuoja, Tisi, Selvi e Kënetave, etj.
- drurë me kurorë vajtuese; Shelgu vajtues.

Megjithëse drurët në përgjithësi i kanë gjethet në ngjyrë jeshile, kjo nuk është e njëlllojtë për të gjitha llojet e drurëve, por ndryshon në nuancën e saj.

#### **Sipas ngjyrës së gjetheve dallojmë:**

- Drurë me gjethe jeshile të errëta, që ne vjeshta kalojnë në të verdha. Gështenja e kalit, lisi i kuq, Blinjtë, Panjat, Plepi i Kanadasë etj. Drurë me gjethe jeshile të qelta, që ne vjeshtë kalojnë në të verdhë të çelët; mështekna, bliri, akacia, sofrja, panja negundo, rrapi etj.
- Drurë me gjethe bojëqielli në jeshile që ne vjeshtë kalojnë në ngjyrë të verdhë si të kuqe; ahu, panja, etj.
- Drurë me gjethe të verdha e jeshile të cilat në vjeshtë kalojnë në okër; mështekna, arra gështenja e butë etj.

#### **Veçori të shkurreve dekorative**

Sipas lartësisë ndahen në: shkurre të larta - mbi 3 metra; shkurre mesatare 1-3 metra; shkurre të ultë deri 1 metër.

Sipas formës së kurorës ndahen në: shkurre më kurorë ovale; jargavani, oleandri etj.; shkurre më kurorë konike; manjola, dëllinja, tisi etj.; shkurre me kurorë si çadër; dëllinja; shkurre me kurorë të hapur që është edhe pjesa më e madhe e tyre; shkurre me kurorë zvarranike, etj.

Mjediset e gjelbëra kanë në përbërjen e tyre të gjithë drurët (pemët), shkurret dhe çdo lloj vegjetacioni tjetër që rritet në vende ku jetojnë, punojnë dhe kryhet aktiviteti njerëzor.

Prioritet i shtimit të gjelbërimit është futja e bimësisë hibride dhe sidomos asaj autoktone (vëndase) me rritje të shpejtë dhe efekteve jo vetëm në aspektin dekorativ (zbukurues) por edhe në të gjitha të mirat e tjera në shërbim të plotë të komunitetit.

Në zgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë(pemë) dhe shkurre është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kryesorë:

- a) Qëllimi i mbjelljeve,
- b) Kushtet e mjedisit dhe
- c) Veçoritë biologjike të llojit.

Me qëllimin që menjëherë mbas mbjelljes mjedisi të ketë atraksionin e duhur në tërësinë e vet dhe sidomos ndaj komunitetit, drurët dhe shkurret dekorative pëzgjidhen me karakteristika dendrometrike të avancuara, në vartësi kjo edhe të llojeve dhe kërkesave të tyre ndaj faktorëve klimatikë dhe edafikë.

*Kështu preferohet që lartësia e trungut të drurëve (pemëve) duhet të jetë 2.5 deri 3.5m, lartësia e kurorës rreth 2m, perimetri (cirkoferenca) në qafën e rrënjës ose në 1.30 m nga toka, duhet të jetë 30 deri 35 cm, kurora të jetë simetrike ne formen karakteristike te llojit me buke dheu.*

*Kushtet e mjedisit janë përcaktuese për zgjedhjen e llojeve të përshatshme për rritje dhe zhvillim normal, në plotësim të kërkesave jo vetëm për krijimin e një peisazhi sa më atraktiv por edhe në funksion të të mirave materiale komplekse për komunitetin.*

*Po kështu në përzgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë dhe shkurre mbahet parasysh përbërja dhe veçoritë biologjike të llojeve në përshtatje të plotë me bimësinë dekorative në një zonë të caktuar, në një bllok banimi apo gjelbërimi përgjatë rrugëve etj.*

*Në llojet e bimësisë së përzgjedhur ka një alternim midis bimësisë dekorative halorë, fletorë dhe shkurre, përherëblertë dhe gjetherënës, si dhe midis formave dhe koloreve, për të krijuar panorama dhe peisazhe të soditshëm dhe të ndryshueshëm në raport me ndryshimin e stinëve.*

## **TEKNIKA E MBJELLJES SË DRURËVE DEKORATIVË**

*Në krijimin e sipërfaqeve të gjelbëra, për të mundësuar efekt të shpejtë dhe të parakohshëm, ka filluar të përdoret rëndom edhe mbjellja e drurëve dekorativë të rritur. Kjo teknikë presupozon mbjelljen e bimësisë dekorative më parë nga fidanishtja në vazo.*

*Kjo teknikë ka filluar të përdoret gjerësisht edhe në institucionin tonë. Kështu përdoret në gjelbërimin e trotuareve të rrugëve të reja dhe të atyre të vjetra ku në radhën e drurëve ekzistues, duhen zëvendësuar drurë të veçantë, të cilët;*

- *si rezultat i veprimit të faktorit objektiv (që përfshin kushtet natyrore), vjetërohen, deformohen, rrëzohen etj., dhe po kështu;*

- *si rezultat i veprimit të faktorit subjektiv (që përfshin veprimtarinë e njeriut) dëmtohen tërësisht ose pjesërisht, me ose pa dashje, dhe humbasin kështu funksionin e tyre dekorativ si dhe prishin njëllojshmërinë e gjelbërimit kudo në tërësinë e vet, në rrugë e blloqe banimi, në sheshe e bulevarde, në lulishtet e qytetit, në lulishtet e institucioneve shtetërore etj.*

*Para se të fillojme mbjelljen e pemëve në vazo, në fund të saj duhet të vendosim gurë, guralecë ose qeramikë të thyer për të parandaluar bllokimin e vrimave me dhe' dhe për të lejuar kullimin e lirë. Më pas brenda vazos hidhet toka, kjo duhet të sigurojë ajrim dhe kullim të mjaftueshëm duke ruajtur sasi të përshtatshme lagështie. Një kompost për qëllime të përgjithshme do t'i sigurojë të gjitha këto dhe mund të plotësohet edhe me plehra organike. Pema e mbjellë në këtë vazo nuk është në gjendje t'i përhapë rrënjët e saj për të arritur ujën, prandaj është e domosdoshme ta ujisim pemën rregullisht. Në këtë rast uji i freskët i shiut është më i miri.*

*Nëse jemi të detyruar që pemën nuk mund ta mbjellim në tokë brenda vitit por do ta mbajmë më shumë, atëherë duhet të sigurohuni që pema të jetojë në rehati duke rifreskuar shtratin e saj çdo vit. Këtë veprim mund ta bëjmë duke hequr dheun e sipërm të lirshëm dhe duke e zëvendësuar atë me dhe' të pasur me pleh.*

*Epërsitë e kesaj metode janë:*

- *Zënie e garantuar dhe zhvillim normal i procesit jetësor të drurëve dhe shkurreve.*



- *Transport i lehtë dhe i shpejtë në objektet e mbjelljes.*
- *Heqje e shpejtë dhe mbjellje e lehtë e bimësisë dekorative në gropat e hapura më parë.*

*Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vegjël, prandaj ky proces kërkon punonjës dhe punëtorë me nivel të lartë kualifikimi, mjete të posaçme të shkuljes, ambalazhimit, ngarkimit në makineri, transportit deri në objekt, shkarkimin dhe deri mbjelljen e tyre duke zbatuar rigorozisht teknikën e domosdoshme.*

## **SHKULJA E DRURËVE**

*Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi 1.30 m (afërsisht në lartësinë e gjoksit të njeriut) nga toka. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, piramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trungu i pemës.*

*Gjatë shkuljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rrënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura. Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, pasi kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Pasi të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, Pasi të ketë përfunduar mbështjellja e bukës së dheut bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasur parasysh madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulen.*

## **TRANSPORTIMI I DRURËVE**

*Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pasha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinq. Me qëllim të gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.*

*Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që e dheut të shtrihet në pjesën e karrocërisë së automjetit. Duhet theksuar se aty ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinq. Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisët për në vendin e mbjelljes edhe vinqi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me rrogözë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulen, transportohen e mbillen kur temperatura zbret në (-10 grade). Për një mbjellje të suksesshme dhe ecuri normale*


vegetative është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po në atë drejtim. Mosrespektimi i këtij kushti shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurorës së fidanit.

## **MBJELLJA E DRURËVE**

Koha e përshtatshme për mbjellje. Drurët dhe shkurret zakonisht mbillen vetëm gjatë periudhës së pushimit të vegetacionit, pikërisht atëherë kur proceset jetësore të tyre zvogëlohen në minimum.

Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja. Në varësi të përmasave të bimësisë së kërkuar hapet dhe gropa, konkretisht për drurë (pemë) me përmasa të diametrit deri 6 cm dhe bukë dheu 60 cm, gropa hapet me përmasa 80x80x80cm. Fidani (druri\_pema) vendoset përpjndikularisht, 30-40cm mbi dheun e hedhur paraprakisht në gropë, i cili duhet të jetë dhe' i mirë vegetal dhe pa gurë apo inerte, druri mbahet drejt nga një punëtor dhe nga dy punëtorët e tjetër fillohet të mbushet nga të gjitha anët me dhe' i cili vazhdimisht ngjishet me këmbë, si në figurën e mëposhtme (figura nr.1).

Në përfundim të procesit duhet të ujitet me ujë të bollshëm. Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe, rreth e përçark saj formohet një unazë dheu e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë ujitjes dhe reshjeve të shiut. Këtë ujë fidani (druri\_pema) do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë.



Mënyra e hapjes së gropës dhe mbjellja e fidanit (drurit\_pemës) figura nr.1

Për ta ruajtur nga përkulja dhe shtrembërimet që mund të shkaktohen nga era, fidani (druri\_pema) atje ku fillon kurora lidhet nga të tëra anët me tel i cili fiksohet në kunjta të futur në tokë. Trupi i fidanit (druri\_pema) në vendin ku lidhet me tel duhet të mbështillet me material të butë ambalazhimi. Kjo lidhje i hiqet vetëm pas 2-3 vjetëve.

## **SHËRBIMET PAS MBJELLJES**

Është e domosdoshme që vitin e parë pas mbjelljes, bimësia dekorative drurë dhe shkurret duhet të ujiten rregullisht çdo tre ditë. Toka poshtë kurorës duhet të shkrihet e prashitet, kurse gjatë verës kur temperatura është e lartë është e nevojshme që t'u bëhet edhe vaditja e spërkatja me ujë e kurorës.

### **KARAKTERISTIKAT DENDROMETRIKE PËR DISA LLOJE DRURË DHE SHKURRE**

- Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 30\_35 cm në 1.3 m nga toka)
- Cedër, (*Cedrus Deodara*), (me perimetër 55\_60 cm në 1.3 m nga toka)
- Banane  $h = 4$  m
- Dafinë me kurorë piramidale
- Dafinë (*Laurus nobilis*), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- Ekualipt, (*Ekualiptus Globulus*), (me perimetër 35\_40 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Ahu , (*Fagus sylvatica*), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Bli, (*Tilia platyphyllos*), (me perimetër 30\_35 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Ah, (*Fagus sylvatica*), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Lisi i Kalifornisë, *Quercus Agrifolia*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V.(Lis, *Quercus*), (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V Ulli, (*Olea Europaea*), (me perimetër 130\_140 cm në 1.3 m nga toka)
- Ulli, (*Olea Europaea*), (me perimetër 130\_140 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Dafinë (*Laurus nobilis*), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Kumbull e Kuqe, (*Prunus Pissardi*), (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Likuidambër, (*Liquidambar styraciflua*), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Liriodendron (*Liriodendron tulipifera*), (me perimetër 18\_20 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Manjolë, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)
- Panjë e Kuqe (*Acer japonicum*), (me perimetër 18\_20 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40\_45 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Panjë e Norvegjisë, *Acer platanoides 'Crimson King'* (Norëay Maple), (me perimetër 18\_20 cm në 1.3 m nga toka)
- Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 20\_25 cm në 1.3 m nga toka)
- Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 60\_70 cm në 1.3 m nga toka)
- Rrap, (*Platanus orientalis*), (me perimetër 80\_85 cm në 1.3 m nga toka)
- F.V. Sofor (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)

- *F.V. Qershi Japoneze (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Frashër, (Fraxinus angustifolia Vahl), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Gështenjë, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Kamfora, (me perimetër 35\_40 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Ilqe, (Quercus Ilex), (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Gledicia, (Gleditsia triacanthos), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi), (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lejlandër, (Cupressocuparis leylandii), h = 4 - 5 m*
- *Manjolë, (Magnolia grandiflora), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Manjolë, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lis, Quercus), (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lofatë, (Cercis siliquastrum), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lofatë, (me perimetër 23\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lofatë, (Cercis siliquastrum), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lis, Quercus), (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Mimozë, (Acacia Dealbata), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18\_20 cm në 1.3 m nga toka)*

#### **SHKURRE**

- *Oleandër, (Nerium oleandër),*
- *Bush (Buxus sempervirens)*
- *Viburnum h = 1 - 1.5 m nga toka*
- *Nandia (Nandina domestica) h= 50cm*
- *Nandina Nano h = 30cm*
- *Loropetalum (Loropetalum chinense) h = 60 - 80 cm*

III.3.2. Në shtojcën 6, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

#### **Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Madhesia e bukes se dheut në (Lit)</b>	<b>Sasia në copë</b>
	<b>Baza materiale</b>		

1	<i>Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)</i>	130	100
2	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka), rruga "Muhamet Deliu"</i>	130	200
3	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)- Rruga Industriale</i>	130	8
	<i>F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Industriale</i>	130	13
	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Industriale</i>	110	35
4	<i>Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)</i>	130	100
5	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), përballë ETC.</i>	150	10
6	<i>Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 50_55 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	50
7	<i>F.V.Pishe e Bute(Pinus Pinea), (me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka), Autostrada TR-DR</i>	220	20
8	<i>Pishe e Bute(Pinus Pinea), (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)</i>	170	30
9	<i>Gështenjë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	110	30
10	<i>Kamfora, (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)</i>	170	30
11	<i>Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 80_85 cm në 1.3 m nga toka)</i>	750	50
12	<i>Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 60_70 cm në 1.3 m nga toka)</i>	600	40
13	<i>Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)</i>	110	500
14	<i>F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Monun</i>	110	7
	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Monun</i>	110	87
15	<i>F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Egnatia</i>	110	13

	<i>F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Egnatia</i>	130	19
	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Egnatia</i>	220	82
	<i>F.V. Dafinë (Laurus nobilis), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Egnatia</i>	70	10
16	<i>Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	110	30
17	<i>F.V. Pisha e Bute, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka), Lulishte prane Megatek</i>	110	20
	<i>F.V.(Lis, Quercus), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka),Lulishte prane Megatek</i>	70	50
	<i>F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Lulishte prane Megatek</i>	70	35
	<i>F.V.(Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Lulishte prane Megatek</i>	70	30
18	<i>F.V Ulli, (Olea Europaea), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga toka), Lulishte prane mbikalimit te kasharit</i>	220	10
19	<i>Lis, Quercus), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	50
20	<i>Ilqe, (Quercus Ilex), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	110	50
21	<i>Lofatë, (me perimetër 23_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	20
22	<i>Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	50
23	<i>F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Iliria</i>	110	10
24	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka),Rruga Bylis</i>	220	7
	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Bylis</i>	220	7
	<i>F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis</i>	70	38
	<i>F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis</i>	70	41

	<i>F.V. Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis</i>	90	2
25	<i>Lis, Quercus), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Pavarsia</i>	90	40
26	<i>F.V. Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Dardania</i>	70	30
27	<i>F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Butrinti</i>	110	10
28	<i>Tespie (me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	40
29	<i>F.V.Qershij Japoneze (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Asim Zeneli</i>	70	20
30	<i>Qershij Japoneze (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)</i>	170	40
31	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Besim Alla</i>	70	50
32	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka). Rruka Thoma Koxhaj</i>	70	30
33	<i>Dafinë me kurorë piramidale</i>	130	20
34	<i>Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	200
35	<i>F.V.Cedër, (Cedrus Deodara), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka), Kryeministria</i>	750	10
36	<i>Cedër, (Cedrus Deodara), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka)</i>	750	10
37	<i>Dafinë (Laurus nobilis), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	70
38	<i>Mimozë, (Acacia Dealbata), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	50
39	<i>Gledicia, (Gleditsia triacanthos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	80
40	<i>F.V.Ahu, (Fagus sylvatica), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Zall-Bastar</i>	70	10
41	<i>Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	80

42	<i>Frashër , (Fraxinus angustifolia Vahl), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	80
43	<i>F.V Ahu , (Fagus sylvatica), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Shengjergj</i>	70	7
44	<i>Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	80
45	<i>Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	80
46	<i>F.V. Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), tek rruga "E Kavajës)</i>	90	150
47	<i>Panjë e Kuqe (Acer japonicum), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	80
48	<i>Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	80
49	<i>F.V. Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka), tek rruga "Ana Konmena"</i>	90	50
50	<i>Lejlandër, (Cupressocuparis leylandii), h = 4 - 5 m</i>	90	500
51	<i>Banane h = 4 m</i>	70	20
52	<i>F.V Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Diga e Liqenit</i>	130	7
53	<i>F.V Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga e Vilave</i>	70	30
54	<i>Ekualipt, (Ekualiptus Globulus), (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	20
55	<i>Lofatë, (Cercis siliquastrum), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	100
56	<i>Manjolë, (Magnolia grandiflora), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	100
57	<i>Ulli, (Olea Europaea), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	50
58	<i>F.V. Panjë e Norvegjisë, Acer platanoides 'Crimson King' (Norëay Maple), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Lek Dukagjini</i>	90	20



59	<i>Selvi Cupressus sempervirens, h = 8 - 8.5 m e lartë</i>	600	30
60	<i>Selvi Cupressus sempervirens, h = 4 - 5 m e lartë</i>	220	100
61	<i>Bush</i>	40	120
62	<i>Nandia (Nandina domestica) h= 50cm</i>	40	500
63	<i>Nandina Nano h = 30cm</i>	33	500
64	<i>Loropetalum (Loropetalum chinense) h = 60 - 80 cm</i>	33	100
65	<i>Viburnum h = 1 - 1.5 m nga toka</i>	70	1000
66	<i>Oleandër, (Nerium oleander),</i>	3	1000
67	<i>F.V Oleandër, (Nerium oleander), Parteri I mesit Rruga e Dibres</i>	3	5000
68	<i>F.V Oleandër, (Nerium oleander), parteri I mesit Rruga Kastriotet</i>	3	10000
69	<i>Pleh organik(kg)</i>		152500
70	<i>Zhalona mbeshtetes (Cope)</i>		970

#### **GRAFIKU I EKZEKUTIMIT; bashkelidhur DST**

*Afati ekzekutimit: 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontrates sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.*

III.3.3. Gjithashtu, autoriteti kontraktor bashkëlidhur dokumenteve të tenderit, ka publikuar për këtë procedurë prokurimi shtojcën "Grafiku F.V Pemë", ku pasqyron Vendndodhjet e pemëve së bashku me koordinatat, si dhe muajt në të cilën do të mbillen.

III.3.4. Në Procesverbalin – Tipi i kontratës - Mall "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim të kontrates me objekt prokurimi "Blerje pemë dekorative për pyllin orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës" për nevojat e DPPGJ për vitin 2023", të publikuar nga autoriteti kontraktor, është argumentuar:

*"Vendndodhja e pemeve dekorative furnizim vendosje:*

*Pemet dekorative (furnizim vendosje) do te mbillen në 27 njësitë administrative të Bashkisë Tiranë, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.*

*Referuar Kërkeses nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Gjellbërimit të Qytetit ndër zonat të cilat rezultojnë më kryesore dhe që kanë nevojë për mbjellje pemesh dekorativë janë te percaktuara sipas njesive administrative perkatese:*

*Mallrat objekt prokurimi do te verifikohen e merren ne dorëzim, rast pas rasti nga nje komision i posaçëm i ngritur nga AK.*

*Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Mallrat e kerkuara do te dorezohen sipas kerkesave dhe nevojave faktike te DPPGJ.”*

III.3.5. Referuar aktit të trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, në lidhje me pretendimin e mësipërm, ky i fundit ka argumentuar: *“Për sa i përket koordinatave të pemëve, AK sigurisht ka kryer një analizë të thelluar përpara se të hedh në DST koordinatat për vendosjen e drurëve dekorativ (pemëve). Megjithatë referuar kërkesës së OE “Albgarden” SHPK, po saktësojmë në mënyrë më specifike siç i kërkon OE me foto bashkëngjitur vendndodhjet për vendosjen e drurëve dekorativ (material bashkëngjitur). Më tej sqarojmë se për çdo paqartësi apo konfuzion, OE “Albgarden” ShPK mund të kontaktojë me Z.M.B, specialist fushe me nr. Cel....., për të kryer vizita nga afër në kantier/në vendndodhjet ku do të kryhet mbjellja (f.v) e drurëve dekorativ, për të pasur kësisoj një panoramë të qartë të çdo detaji dhe mos të ndihet konfuz mbi procesin e mbjelljeve që do të kryhen.”*

III.3.6. KPP nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit vëren, se autoriteti kontraktor ka parashikuar, konkretisht në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” sasinë e mallit që do të furnizohet dhe vendoset. Gjithashtu, autoriteti kontraktor bashkëlidhur dokumenteve të tenderit ka publikuar për këtë procedurë prokurimi shtojcën ”Grafiku F.V Pemë”, ku pasqyron Vendndodhjet e pemëve që do të mbillen, së bashku me koordinatat, si dhe muajt përkatës në të cilën do të mbillen.

Nga verifikimi i dokumentacionit të publikuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi, KPP konstaton, se në Procesverbalin *“Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim te kontrates me objekt prokurimi “Blerje pemë dekorative për pyllin orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës” për nevojat e DPPGJ per vitin 2023”*, ky i fundit ka argumentuar, se *“Pemet dekorative (furnizim vendosje) do te mbillen në 27 njësitë administrative të Bashkisë Tiranë, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor”*.

Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me përcaktimin e saktë të koordinatave për vendosjen e pemëve, gjykojmë, se për operatorin ekonomik, në përgatitjen e ofertës së tij, është e rëndësishme të këtë të qartë sasinë e mallit që do të furnizojë, llojin e tij, së bashku me specifikimet teknike të mirëpërcaktuara, si dhe zonën në të cilën do të vendosen, kërkesa këto të cilat janë përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor. Për sa i përket koordinatave gjeografike në të cilat do të mbillet ekzaktësisht secila nga pemët apo bimët e tjera dekorative, gjykojmë se kjo është një kërkesë e cila në thelb nuk cenon interesin e ligjshëm të operatorit ekonomik ofertues, apo të këtë ndikim në përgatitjen e ofertës së tij ekonomike. Kështu që, rrjedhimisht gjykojmë se kërkesa e operatorit ekonomik ankimues nuk është një kërkesë e drejtë, e cila kufizon pjesëmarrjen e operatorit ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, se “Referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, rezulton se natyra dhe numri i mjeteve të kërkuara nga AK, për më tepër për një kontratë furnizimi malli nuk është në përputhje dhe proporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës. AK nuk ka dhënë asnjë argumentim ligjor apo teknik lidhur me kërkesat konkrete për mjetet e kërkuar, duke përcaktuar kështu kërkesa abuzive. Po kështu, nga analiza e proceseve të mbjelljes së drurëve dhe shkurreve dekorative, ne evidentuam edhe mjetet konkrete që nevojiten për realizimin me sukses të kontratës. Nga kjo analizë rezulton se është e paqartë dhe e pambështetur teknikisht se pse kërkohet:

- 1) Prozhektorë ndriçimi (të gjitha punimet do të kryhen brenda 8 orarit të punës dhe nuk parashikohet asnjë proces që do të kryhet natën ku mund të nevojiten prozhektorë);
- 2) Kamion me vinç janë kërkuar 3, ndërkohë që referuar analizës tonë proceset e punës mund ti kryejë edhe vetëm një kamion me vinç;
- 3) Dumper kërkohen 2, ndërkohë që referuar analizës tonë proceset e punës mund ti kryejë edhe vetëm me një dumper;
- 4) Mjetet; Eskavator me goma, fadromë dhe minifadromë, nuk nevojiten fare në procesin e mbjelljes së drurëve dhe shkurreve dekorativë, ndërkohë që në mënyrë të paargumentuar teknikisht janë kërkuar nga AK.

Referuar gjithë analizës së sipërcituar, rezulton se kriteri për mjete e makineri nuk është në përputhje me përmasat e kontratës e për pasojë ky kriter duhet të modifikohet.”

III.4.1. Referuar aktit të trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, ky i fundit ka pranuar pjesërisht pretendimet e operatorit ekonomik si më poshtë:

“[...] megjithatë AK e ka rishikuar kërkesën në fjalë duke e ulur numrin e prozhektorëve të ndriçimit në 2 (dy) copë.

[...] AK e ka rishikuar kërkesën e saj në lidhje me mjetet e llojit kamion me vinç duke e pranuar ankesën e OE “Albgarden” SHPK duke e ulur numrin në 1 (një) të tillë.

AK e ka rishikuar kërkesën e saj në lidhje me mjetet e llojit dumper kantieri duke e ulur numrin në 1 (një) të tillë.

Për sa i përket kërkesës për 1 (një) ekskavator me goma, sqarojmë se: Përdorimi i ekskavatorit për mbjellje pemësh është një praktikë e zakonshme dhe e efektshme në shumë projekte të mbjelljes, veçanërisht kur ka një sasi të madhe pemësh që duhet të mbjellen në një kohë të shkurtër. Ekskavatorët janë pajisje të fuqishme dhe veçanërisht të dobishme për punët e hapjes së gropave ku do të vendoset çdo pemë. Më poshtë rendisim disa avantazhe të përdorimit të ekskavatorit në mbjelljen e pemëve: [...]

Për sa i përket kërkesës për fadromë dhe mini fadromë, sqarojmë se:

Ak pranon ankesën e OE “Albgarden” SHPK për sa i përket kërkesës së fadromës duke e hequr atë si kriter.

*Ndërkohë; Për sa i përket përdorimit të mini-fadromës, sqarohet se: Mini fadroma është një mjet i përshtatshëm për punët e mbjelljes në hapësira të ngushta dhe vështira ku fadroma më të mëdha nuk mund të arrijnë. Disa avantazhe të përdorimit të mini fadromave për mbjelljen e pemëve [...]”.*

III.4.2. Me anë të shkresës nr.949/1 prot., datë 27.07.2023, protokolluar pranë KPP me nr.1697/3 prot., datë 01.08.2023, operatori ekonomik “Alb Garden” SHPK, ka paraqitur argumente shtesë në lidhje me trajtimin e ankesës së tij nga ana e autoritetit kontraktor. Konkretisht operatori ekonomik pretendon si më poshtë:

- “1. AK e ka pranua plotësisht pretendimin nr.1 të sipërcituar;*
- 2. AK e ka pranuar pjesërisht pretendimin nr.2 të sipërcituar, duke ndryshuar kriterin për vjetërsinë në punët të Inxhinierëve nga 5 vite eksperiencë në 3 vite eksperiencë;*
- 3. AK e ka pranuar plotësisht pretendimin nr.3 të sipërcituar, duke e ulur numrin e punëtorëve nga 49 punonjës në 25 punonjës;*
- 4. AK e ka pranuar plotësisht pretendimin nr.4 të sipërcituar, duke e hequr kriterin për punonjës në lartësi;*
- 5. AK nuk e ka pranuar pretendimin nr.5 të sipërcituar, për heqjen e kriterit të paraqitjes së mostrave;*
- 6. AK e ka pranuar pjesërisht pretendimin nr.6 të sipërcituar, duke hequr disa mjete e makineri si dhe duke ulur numrin e mjeteve e makinerive që OE duhet të disponojnë.*
- 7. AK deklaron se e ka pranuar pretendimin nr.7 të sipërcituar, duke na vënë në dispozicion disa foto me vendndodhjet se ku do të mbillen drurët dekorativë.*

***Lidhur me pretendimet 2, 5 dhe 7 të cilat AK ose i ka pranuar pjesërisht (pretendimet 2 dhe 7) ose nuk e ka pranuar (pretendimi nr.5), pasi jemi njohur me përgjigjen e AK me anë të kësaj shkrese paraqesim dhe sjellim në vëmendje të KPP disa argumente shtesë. [...]”.***

III.4.3. Sa më sipër, KPP, nga shqyrtimi i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me modifikimin e kërkesave për mjete, si dhe aktit të trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, konstaton, se ky i fundit ka pranuar pjesërisht pretendimet e ankimuesit në lidhje me mjetet (si më sipër pasqyruar).

Operatori ekonomik “Alb Garden” SHPK me anë të shkresës nr.949/1 prot., datë 27.07.2023, protokolluar pranë KPP me nr.1697/3 prot., datë 01.08.2023, ka paraqitur argumente shtesë pranë KPP-së në lidhje me trajtimin e ankesës së tij nga ana e autoritetit kontraktor. Konkretisht, konstatohet, se operatori ekonomik ankimues, ngre argumente shtesë mbi tre nga pretendimet e tij të cilat janë pranuar pjesërisht ose janë refuzuar nga autoriteti kontraktor, por nuk ngre pretendime në lidhje me mjetet.

III.4.4. Në shtojcën 7, pika 2.3.8 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.8 Ofertuesi duhet të disponojë te vetat ose me qira këto makineri:**

<b>Pershkrimi</b>	<b>Sasia</b>
<i>Kamion me vinc</i>	<i>3 (tre) cope</i>
<i>Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës te pakten min 10 ton</i>	<i>3 (tre) cope</i>
<i>Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 1 – 3.5 ton</i>	<i>1 (nje) cope</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 (nje) copë</i>
<i>Fadrome</i>	<i>1 (nje) copë</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>1 (nje) cope</i>
<i>Minifadrome</i>	<i>1 (nje) cope</i>
<i>Damper kantieri</i>	<i>2 (dy) cope</i>
<i>Autobot Uji</i>	<i>2 (dy) copë</i>
<i>Kokore/Kapele mbrojtese</i>	<i>49 (dyzet e nente) copë</i>
<i>Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila</i>	<i>5 (pese) cope</i>
<i>Prozhektorë ndriçimi</i>	<i>5 (pese) cope</i>
<i>Komplet i ndimës së shpejtë</i>	<i>10 (dhjete) cope</i>
<i>Tabela paralajmëruese për bllokimin dhe devijimin e rruges</i>	<i>20 (njetzet) cope</i>

Per te deshmuar këtë, Formulari i shtojces 8 te DST duhet te shoqerohet me dokumentet e meposhtme:

- a) *Makineritë dhe pajisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje të lidhura para noterit publik, si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (origjinal ose fotokopje e noterizuar).*
- b) *Kohëzgjatja e kontratave të qerasë për makineritë/pajisjet në fjalë duhet të mbulojë të gjithë kohën e parashikuar në Grafikon e realizimit te kontrates.*
- c) *Për mjetet që shënohen në regjistrat publik me qira ose ne pronesi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (Certifikatat pronësie, leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Për pajisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose*

*faturat e blerjes, originalë ose fotokopje e noterizuar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.*

*Në rast se dokumentet e mësipërme janë në gjuhë të huaj, ato detyrimisht duhet të shoqërohen me një përkthim në gjuhën e ofertes, si dhe noterizimin e nënshkrimit të përkthimit*

III.4.5. Në shtojcën 5, “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### ***Bimësia dekorative (drurë\_shkurre) dhe kompozimi në gjelbërim.***

*Në sipërfaqet e gjelbëra elementi bazë dhe faktori kryesor që përcakton kompozimin e tyre estetik mbetet gjithmonë bimësia dekorative.*

*Bimësia dekorative mund të lihet me rritje natyrore ose mund ti jepet edhe forma të rregullta sferike dhe gjeometrike, paralelepipedë, konike, etj.*

#### ***Veçoritë e drurëve dekorativë:***

- *drurë me kurorë ovale; Panja, Mështekëna, Ahu, Gështenja, Sofora, Bli, Lisi, etj.*
- *drurë me kurorë të rrumbullakët; Gështenja e Kalit, Katabla, Plepi, Shelgu etj.*
- *drurët me kurorë konike; Likuidambër, Manjolë, Rrapi, Bli, Akacia etj.*
- *drurë me kurorë si kolonë; Mështekën, Ah, Verri, etj.*
- *drurë me kurorë sferike; Panja, Frashëri, Akacia etj.*
- *drurë me kurorë të shtrirë si çadër; Julibrisimi, Plepi i Bardhë, Cedruset, Pishat, etj.*
- *drurë me kurorë konike; Bredhi, Selvia, Varshi, Gjinko, Kryptomeria, Pisha, Sekuoja, Tisi, Selvi e Kënetave, etj.*
- *drurë me kurorë vajtuase; Shelgu vajtues.*

*Megjithëse drurët në përgjithësi i kanë gjethet në ngjyrë jeshile, kjo nuk është e njëlllojtë për të gjitha llojet e drurëve, por ndryshon në nuancën e saj.*

#### ***Sipas ngjyrës së gjetheve dallojmë:***

▪ *Drurë me gjethe jeshile të errëta, që në vjeshta kalojnë në të verdha. Gështenja e kalit, lisi i kuq, Blinjtë, Panjat, Plepi i Kanadasë etj. Drurë me gjethe jeshile të qelta, që në vjeshtë kalojnë në të verdhë të çelët; mështekna, bliri, akacia, sofra, panja negundo, rrapi etj.*

▪ *Drurë me gjethe bojëqielli në jeshile që në vjeshtë kalojnë në ngjyrë të verdhë si të kuqe; ahu, panja, etj.*

▪ *Drurë me gjethe të verdha e jeshile të cilat në vjeshtë kalojnë në okër; mështekna, arra gështenja e butë etj.*

#### ***Veçori të shkurreve dekorative***

*Sipas lartësisë ndahen në: shkurre të larta - mbi 3 metra; shkurre mesatare 1-3 metra; shkurre të ultë deri 1 metër.*

*Sipas formës së kurorës ndahen në: shkurre më kurorë ovale; jargavani, oleandri etj.; shkurre më kurorë konike; manjola, dëllinja, tisi etj.; shkurre me kurorë si çadër; dëllinja; shkurre me kurorë të hapur që është edhe pjesa më e madhe e tyre; shkurre me kurorë zvarranike, etj.*

*Mjediset e gjelbëra kanë në përbërjen e tyre të gjithë drurët (pemët), shkurret dhe çdo lloj vegjetacioni tjetër që rritet në vende ku jetojnë, punojnë dhe kryhet aktiviteti njerëzor.*

*Prioritet i shtimit të gjelbërimit është futja e bimësisë hibride dhe sidomos asaj autoktone (vëndase) me rritje të shpejtë dhe efekteve jo vetëm në aspektin dekorativ (zbukurues) por edhe në të gjitha të mirat e tjera në shërbim të plotë të komunitetit.*

*Në zgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë(pemë) dhe shkurre është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kryesorë:*

- a) Qëllimi i mbjelljeve,*
- b) Kushtet e mjedisit dhe*
- c) Veçoritë biologjike të llojit.*

*Me qëllimin që menjëherë mbas mbjelljes mjedisi të ketë atraksionin e duhur në tërësinë e vet dhe sidomos ndaj komunitetit, drurët dhe shkurret dekorative pëzgjidhen me karakteristika dendrometrike të avancuara, në vartësi kjo edhe të llojeve dhe kërkesave të tyre ndaj faktorëve klimatikë dhe edafikë.*

*Kështu preferohet që lartësia e trungut të drurëve (pemëve) duhet të jetë 2.5 deri 3.5m, lartësia e kurorës rreth 2m, perimetri (cirkoferenca) në qafën e rrënjës ose në 1.30 m nga toka, duhet të jetë 30 deri 35 cm, kurora të jetë simetrike ne formen karakteristike te llojit me buke dheu.*

*Kushtet e mjedisit janë përcaktuese për zgjedhjen e llojeve të përshatshme për rritje dhe zhvillim normal, në plotësim të kërkesave jo vetëm për krijimin e një peisazhi sa më atraktiv por edhe në funksion të të mirave materiale komplekse për komunitetin.*

*Po kështu në përzgjedhjen e llojeve të bimësisë dekorative drurë dhe shkurre mbahet parasysh përbërja dhe veçoritë biologjike të llojeve në përshtatje të plotë me bimësinë dekorative në një zonë të caktuar, në një bllok banimi apo gjelbërimi përgjatë rrugëve etj.*

*Në llojet e bimësisë së përzgjedhur ka një alternim midis bimësisë dekorative halorë, fletorë dhe shkurre, përherëblertë dhe gjetherënës, si dhe midis formave dhe koloreve, për të krijuar panorama dhe peisazhe të soditshëm dhe të ndryshueshëm në raport me ndryshimin e stinëve.*

## **TEKNIKA E MBJELLJES SË DRURËVE DEKORATIVË**

*Në krijimin e sipërfaqeve të gjelbëra, për të mundësuar efekt të shpejtë dhe të parakohshëm, ka filluar të përdoret rëndom edhe mbjellja e drurëve dekorativë të rritur. Kjo teknikë presupozon mbjelljen e bimësisë dekorative më parë nga fidanishtja në vazo.*

*Kjo teknikë ka filluar të përdoret gjerësisht edhe në institucionin tonë. Kështu përdoret në gjelbërimin e trotuareve të rrugëve të reja dhe të atyre të vjetra ku në radhën e drurëve ekzistues, duhen zëvendësuar drurë të veçantë, të cilët;*

○ si rezultat i veprimit të faktorit objektiv (që përfshin kushtet natyrore), vjetërohen, deformohen, rrëzohen etj., dhe po kështu;

○ si rezultat i veprimit të faktorit subjektiv (që përfshin veprimtarinë e njeriut) dëmtohen tërësisht ose pjesërisht, me ose pa dashje, dhe humbasin kështu funksionin e tyre dekorativ si dhe prishin njëllojshmërinë e gjelbërimit kudo në tërësinë e vet, në rrugë e blloqe banimi, në sheshe e bulevarde, në lulishtet e qytetit, në lulishtet e institucioneve shtetërore etj.

Para se të fillojme mbjelljen e pemëve në vazo, në fund të saj duhet të vendosim gurë, guralecë ose qeramikë të thyer për të parandaluar bllokimin e vrimave me dhe' dhe për të lejuar kullimin e lirë. Më pas brenda vazos hidhet toka, kjo duhet të sigurojë ajrim dhe kullim të mjaftueshëm duke ruajtur sasi të përshtatshme lagështie. Një kompost për qëllime të përgjithshme do t'i sigurojë të gjitha këto dhe mund të plotësohet edhe me plehra organike. Pema e mbjellë në këtë vazo nuk është në gjendje t'i përhapë rrënjët e saj për të arritur ujin, prandaj është e domosdoshme ta ujisim pemën rregullisht. Në këtë rast uji i freskët i shiut është më i miri.

Nëse jemi të detyruar që pemën nuk mund ta mbjellim në tokë brenda vitit por do ta mbajmë më shumë, atëherë duhet të sigurohuni që pema të jetojë në rehati duke rifreskuar shtratin e saj çdo vit. Këtë veprim mund ta bëjmë duke hequr dheun e sipërm të lirshëm dhe duke e zëvendësuar atë me dhe' të pasur me pleh.

Epërsitë e kesaj metode janë:

- Zënie e garantuar dhe zhvillim normal i procesit jetësor të drurëve dhe shkurreve.
- Transport i lehtë dhe i shpejtë në objektet e mbjelljes.
- Heqje e shpejtë dhe mbjellje e lehtë e bimësisë dekorative në gropat e hapura më parë.

Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vegjël, prandaj ky proces kërkon punonjës dhe punëtorë me nivel të lartë kualifikimi, mjete të posaçme të shkuljes, ambalazhimit, ngarkimit në makineri, transportit deri në objekt, shkarkimin dhe deri mbjelljen e tyre duke zbatuar rigorozisht teknikën e domosdoshme.

## **SHKULJA E DRURËVE**

Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi 1.30 m (afërsisht në lartësinë e gjoksit të njeriut) nga toka. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, piramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trungu i pemës.

Gjatë shkuljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rrënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura. Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, pasi kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Pasi të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, Pasi të ketë përfunduar



*mbështjellja e bukës së dheut bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasur parasysh madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulen.*

### **TRANSPORTIMI I DRURËVE**

*Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pasha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinq. Me qëllim të gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.*


*Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që e dheut të shtrihet në pjesën e karrocërisë së automjetit. Duhet theksuar se aty ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinq. Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisat për në vendin e mbjelljes edhe vinqi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me rrogözë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulen, transportohen e mbillen kur temperatura zbret në (-10 grade). Për një mbjellje të suksesshme dhe ecuri normale vegjetative është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po në atë drejtim. Mosrespektimi i këtij kushti shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurorës së fidanit.*

### **MBJELLJA E DRURËVE**

*Koha e përshtatshme për mbjellje. Drurët dhe shkurret zakonisht mbillen vetëm gjatë periudhës së pushimit të vegjetacionit, pikërisht atëherë kur proceset jetësore të tyre zvogëlohen në minimum.*

*Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja. Në varësi të përmasave të bimësisë së kërkuar hapet dhe gropa, konkretisht për drurë (pemë) me përmasa të diametrit deri 6 cm dhe bukë dheu 60 cm, gropa hapet me përmasa 80x80x80cm. Fidani (druri\_pema) vendoset përpendikularisht, 30-40cm mbi dheun e hedhur paraprakisht në gropë, i cili duhet të jetë dhe' i mirë vegjetal dhe pa gurë apo inerte, druri mbahet drejt nga një punëtor dhe nga dy punëtorët e tjetër fillohet të mbushet nga të gjitha anët me dhe' i cili vazhdimisht ngjishet me këmbë, si në figurën e mëposhtëme (figura nr.1).*

*Në përfundim të procesit duhet të ujitet me ujë të bollshëm. Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe, rreth e përçark saj formohet një unazë dheu e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë ujitjes dhe reshjeve të shiut. Këtë ujë fidani (druri\_pema) do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë.*



*Mënyra e hapjes së gropës dhe mbjellja e fidanit (drurit\_pemës) figura nr.1*

*Për ta ruajtur nga përkulja dhe shtrembërimet që mund të shkaktohen nga era, fidani (druri\_pema) atje ku fillon kurora lidhet nga të tëra anët me tel i cili fiksohet në kunjta të futur në tokë. Trupi i fidanit (druri\_pema) në vendin ku lidhet me tel duhet të mbështillet me material të butë ambllazhimi. Kjo lidhje i hiqet vetëm pas 2-3 vjetëve.*

### **SHËRBIMET PAS MBJELLJES**

*Është e domosdoshme që vitin e parë pas mbjelljes, bimësia dekorative drurë dhe shkurret duhet të ujitën rregullisht çdo tre ditë. Toka poshtë kurorës duhet të shkrihet e prashitet, kurse gjatë verës kur temperatura është e lartë është e nevojshme që t'u bëhet edhe vaditja e spërkatja me ujë e kurorës.*

### **KARAKTERISTIKAT DENDROMETRIKE PËR DISA LLOJE DRURË DHE SHKURRE**

- *Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30\_35 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Cedër, (Cedrus Deodara), (me perimetër 55\_60 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Banane h = 4 m*
- *Dafinë me kurorë piramidale*
- *Dafinë (Laurus nobilis), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Ekualipt, (Ekualiptus Globulus), (me perimetër 35\_40 cm në 1.3 m nga toka)*
- *F.V Ahu , (Fagus sylvatica), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *F.V Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30\_35 cm në 1.3 m nga toka)*
- *F.V Ah, (Fagus sylvatica), (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *F.V Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*

- *F.V. (Lis, Quercus)*, (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V Ulli, (Olea Europaea)*, (me perimetër 130\_140 cm në 1.3 m nga toka)
- *Ulli, (Olea Europaea)*, (me perimetër 130\_140 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V. Dafinë (Laurus nobilis)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V. Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi)*, (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V. Liriodendron (Liriodendron tulipifera)*, (me perimetër 18\_20 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V. Manjolë, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Panjë e Kuqe (Acer japonicum)*, (me perimetër 18\_20 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40\_45 cm në 1.3 m nga toka)*
- *F.V. Panjë e Norvegjisë, Acer platanoides 'Crimson King' (Norëay Maple)*, (me perimetër 18\_20 cm në 1.3 m nga toka)
- *Rrap, (Platanus orientalis)*, (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V. Rrap, (Platanus orientalis)*, (me perimetër 20\_25 cm në 1.3 m nga toka)
- *Rrap, (Platanus orientalis)*, (me perimetër 60\_70 cm në 1.3 m nga toka)
- *Rrap, (Platanus orientalis)*, (me perimetër 80\_85 cm në 1.3 m nga toka)
- *F.V. Sofor (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *F.V. Qershia Japoneze (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Frashër, (Fraxinus angustifolia Vahl)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *Gështenjë, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Kamfora, (me perimetër 35\_40 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Ilqe, (Quercus Ilex)*, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)
- *Gledicia, (Gleditsia triacanthos)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi)*, (me perimetër 16\_18 cm në 1.3 m nga toka)
- *Lejlandër, (Cupressocyparis leylandii)*, h = 4 - 5 m
- *Manjolë, (Magnolia grandiflora)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *Manjolë, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lis, Quercus*, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)
- *Lofatë, (Cercis siliquastrum)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *Lofatë, (me perimetër 23\_30 cm në 1.3 m nga toka)*
- *Lofatë, (Cercis siliquastrum)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *Lis, Quercus*, (me perimetër 25\_30 cm në 1.3 m nga toka)
- *Mimozë, (Acacia Dealbata)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *Likuidambër, (Liquidambar styraciflua)*, (me perimetër 14\_16 cm në 1.3 m nga toka)
- *Liriodendron (Liriodendron tulipifera)*, (me perimetër 18\_20 cm në 1.3 m nga toka)

## SHKURRE

- *Oleandër, (Nerium oleandër),*
- *Bush (Buxus sempervirens)*
- *Viburnum h = 1 - 1.5 m nga toka*
- *Nandia (Nandina domestica) h= 50cm*
- *Nandina Nano h = 30cm*
- *Loropetalum (Loropetalum chinense) h = 60 - 80 cm*

III.4.6. Në shtojcën 6, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimet”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

### *Sasia e mallit që kërkohet:*

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Madhesia e bukes se dheut në (Lit)</i>	<i>Sasia në copë</i>
	<b><i>Baza materiale</i></b>		
1	<i>Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)</i>	130	100
2	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka), rruga "Muhamet Deliu"</i>	130	200
3	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)- Rruga Industriale</i>	130	8
	<i>F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Industriale</i>	130	13
	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Industriale</i>	110	35
4	<i>Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)</i>	130	100
5	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), përballë ETC.</i>	150	10
6	<i>Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 50_55 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	50
7	<i>F.V.Pishe e Bute(Pinus Pinea), (me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka), Autostrada TR-DR</i>	220	20

8	<i>Pishe e Bute(Pinus Pinea), (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)</i>	170	30
9	<i>Gështenjë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	110	30
10	<i>Kamfora, (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)</i>	170	30
11	<i>Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 80_85 cm në 1.3 m nga toka)</i>	750	50
12	<i>Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 60_70 cm në 1.3 m nga toka)</i>	600	40
13	<i>Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)</i>	110	500
14	<i>F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Monun</i>	110	7
	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Monun</i>	110	87
15	<i>F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Egnatia</i>	110	13
	<i>F.V. Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Egnatia</i>	130	19
	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Egnatia</i>	220	82
	<i>F.V. Dafinë (Laurus nobilis), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Egnatia</i>	70	10
16	<i>Manjolë, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	110	30
17	<i>F.V Pishe e Bute, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka), Lulishte prane Megatek</i>	110	20
	<i>F.V.(Lis, Quercus), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka),Lulishte prane Megatek</i>	70	50
	<i>F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Lulishte prane Megatek</i>	70	35
	<i>F.V.(Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Lulishte prane Megatek</i>	70	30
18	<i>F.V Ulli, (Olea Europaea), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga</i>	220	10

	<i>toka), Lulishte prane mbikalimit te kasharit</i>		
19	<i>Lis, Quercus), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	50
20	<i>Ilqe, (Quercus Ilex), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	110	50
21	<i>Lofatë, (me perimetër 23_30 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	20
22	<i>Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	50
23	<i>F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Iliria</i>	110	10
24	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka),Rruga Bylis</i>	220	7
	<i>F.V. Panjë e Kuqe (me perimetër 40_45 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Bylis</i>	220	7
	<i>F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis</i>	70	38
	<i>F.V. Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis</i>	70	41
	<i>F.V. Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka).Rruga Bylis</i>	90	2
25	<i>Lis, Quercus), (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Pavarsia</i>	90	40
26	<i>F.V. Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Dardania</i>	70	30
27	<i>F.V. Rrap, (Platanus orientalis),, (me perimetër 20_25 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Butrinti</i>	110	10
28	<i>Tespie (me perimetër 45_50 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	40
29	<i>F.V.Qershii Japoneze (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Asim Zeneli</i>	70	20
30	<i>Qershii Japoneze (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka)</i>	170	40
31	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Besim Alla</i>	70	50
32	<i>F.V. Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga</i>	70	30

	<i>toka). Rruka Thoma Koxhaj</i>		
33	<i>Dafinë me kurorë piramidale</i>	130	20
34	<i>Sofor (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	200
35	<i>F.V.Cedër, (Cedrus Deodara), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka), Kryeministria</i>	750	10
36	<i>Cedër, (Cedrus Deodara), (me perimetër 55_60 cm në 1.3 m nga toka)</i>	750	10
37	<i>Dafinë (Laurus nobilis), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	70
38	<i>Mimozë, (Acacia Dealbata), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	50
39	<i>Gledicia, (Gleditsia triacanthos), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	80
40	<i>F.V.Ahu , (Fagus sylvatica), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Zall-Bastar</i>	70	10
41	<i>Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	80
42	<i>Frashër , (Fraxinus angustifolia Vahl), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	80
43	<i>F.V.Ahu , (Fagus sylvatica), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Shengjergj</i>	70	7
44	<i>Likuidambër, (Liquidambar styraciflua), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	70	80
45	<i>Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	80
46	<i>F.V. Kumbull e Kuqe, (Prunus Pissardi), (me perimetër 16_18 cm në 1.3 m nga toka), tek rruga "E Kavajës)</i>	90	150
47	<i>Panjë e Kuqe (Acer japonicum), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	80
48	<i>Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	80
49	<i>F.V. Liriodendron (Liriodendron tulipifera), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka), tek rruga "Ana Konmena"</i>	90	50

50	<i>Lejlandër, (Cupressocuparis leylandii), h = 4 - 5 m</i>	90	500
51	<i>Banane h = 4 m</i>	70	20
52	<i>F.V Bli, (Tilia platyphyllos), (me perimetër 30_35 cm në 1.3 m nga toka), Rruga Diga e Liqenit</i>	130	7
53	<i>F.V Lisi i Kalifornisë, Quercus Agrifolia, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka), Rruga e Vilave</i>	70	30
54	<i>Ekualipt, (Ekualiptus Globulus), (me perimetër 35_40 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	20
55	<i>Lofatë, (Cercis siliquastrum), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	100
56	<i>Manjolë, (Magnolia grandiflora), (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)</i>	90	100
57	<i>Ulli, (Olea Europaea), (me perimetër 130_140 cm në 1.3 m nga toka)</i>	220	50
58	<i>F.V. Panjë e Norvegjisë, Acer platanoides 'Crimson King' (Norëay Maple), (me perimetër 18_20 cm në 1.3 m nga toka). Rruga Lek Dukagjini</i>	90	20
59	<i>Selvi Cupressus sempervirens, h = 8 - 8.5 m e lartë</i>	600	30
60	<i>Selvi Cupressus sempervirens, h = 4 - 5 m e lartë</i>	220	100
61	<i>Bush</i>	40	120
62	<i>Nandia (Nandina domestica) h= 50cm</i>	40	500
63	<i>Nandina Nano h = 30cm</i>	33	500
64	<i>Loropetalum (Loropetalum chinense) h = 60 - 80 cm</i>	33	100
65	<i>Viburnum h = 1 - 1.5 m nga toka</i>	70	1000
66	<i>Oleandër, (Nerium oleander),</i>	3	1000
67	<i>F.V Oleandër, (Nerium oleander), Parteri I mesit Rruga e Dibres</i>	3	5000
68	<i>F.V Oleandër, (Nerium oleander), parteri I mesit Rruga Kastriotet</i>	3	10000
69	<i>Pleh organik(kg)</i>		152500
70	<i>Zhalona mbeshtetes (Cope)</i>		970



## **GRAFIKU I EKZEKUTIMIT; bashkelidhur DST**

*Afati ekzekutimit: 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontrates sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.*

III.4.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.4.8. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.9. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar*

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.10. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, si dhe akti i trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet, se ky i fundit ka pranuar plotësisht pretendimet për uljen e numrit të mjeteve të llojit kamion me vinç dhe dumper kantieri. Gjithashtu, ka pranuar plotësisht kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e mjetit Fadromë.

Ndërkohë, lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e mjeteve “prozhektor”, autoritetit kontraktor e ka rishikuar kërkesën në fjalë duke e ulur numrin e prozhektorëve të ndriçimit në 2 (dy) copë, nga 5 (pesë) të kërkuar, duke argumentuar se “Sqarojmë se kërkesa e AK që OE pjesëmarrës të jenë të pajisur me prozhektorë ndriçimi i referohet faktit se duke qenë se një pjesë e drurëve dekorativë do të mbillen në trotuare/rrugë ku ka prezencë masive trafiku, procesi i mbjelljes për shkak të kushteve teknike, logjistike dhe të sigurisë në punë mund të zhvillohet gjatë orëve të mbrëmjes/natës, atëherë kur trafiku është edhe më i rrallë. Megjithatë AK e ka rishikuar kërkesën në fjalë duke e ulur numrin e prozhektorëve të ndriçimit në 2 (dy) copë.”

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e mjeteve 1 (një) ekskavator me goma dhe 1 (një) minifadromë, autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës ka argumentuar se “Për sa i përket kërkesës për 1 (një) ekskavator me goma, sqarojmë se: Përdorimi i ekskavatorit për mbjellje pemësh është një praktikë e zakonshme dhe e efektshme në shumë projekte të mbjelljes, veçanërisht kur ka një sasi të madhe pemësh që duhet të mbjellen në një kohë të shkurtër. Ekskavatorët janë pajisje të fuqishme dhe veçanërisht të dobishme për punët e hapjes

*së gropave ku do të vendoset çdo pemë. Më poshtë rendisim disa avantazhe të përdorimit të ekskavatorit në mbjelljen e pemëve: [...]*

*Ndërkohë; Për sa i përket përdorimit të mini-fadromës, sqarojmë se: Mini fadroma është një mjet i përshtatshëm për punët e mbjelljes në hapësira të ngushta dhe vështira ku fadroma më të mëdha nuk mund të arrijnë. Disa avantazhe të përdorimit të mini fadromave për mbjelljen e pemëve [...]*”.

Sa më sipër, bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, specifikimeve teknike, shpjegimit dhe argumentimit të dhënë nga autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kërkesa e autoritetit kontraktor për dy prozhektorë, 1 ekskavator me goma dhe 1 minifadromë, janë kërkesa të domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, referuar specifikimeve teknike dhe grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për procedurën objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik pas analizimit të të gjitha kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor për furnizimin me pemë, transportimit, mbjelljes së tyre, si dhe shërbimeve pas mbjelljes, që do të kryhen në objektin e prokurimit, si dhe nisur nga afati i përcaktuar për realizimin e këtij objekti, gjykon, se kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi disponimin e mjeteve dy prozhektorë, 1 ekskavator me goma dhe 1 minifadromë, janë kërkesa të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës dhe në proporcion me të.

Gjithashtu, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës i cili ka të drejtën të përcaktojë nevojat e tij, si dhe të kërkojë nga operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, gjithnjë në përputhje dhe në proporcion me përmasat dhe volumin e kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

*Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AlbGarden” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-74343-07-05-2023, me objekt: “*Blerje pemë dekorative për Pyllin Orbital dhe zona të ndryshme të Tiranës*”, me fond limit 59.500.000 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 07.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “AlbGarden” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

